

KËRKESË

Nr. 4295/6, datë 11.10.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerim i varrezave publike” në Bashkinë e Elbasanit.

Subjekti kërkuar është Bashkia e Elbasanit. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 3 219 000 (tre milionë e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I PUNËVE
TË BRENDSHME
Elona Gjebrea

Lista e emërore e personave dhe pronave që do të shpronësohen për efekt të shpronësimit,
që do të përdoret për “Zgjerimin e varrezave publike të qytetit të Elbasanit

Nr	Emri Mbiemri	Nr. i pasurisë	Zona Kadastrale	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja që shpronësohet në m ²	Çmimi në lek/m ²	Vlera e shpronësimit në lek	Lloji i dokumentit të pronësisë
1	Ahmet Mustafa Kadzadej dhe bashkëpronarët	227/4	8527	Arë	3500	222	777000	Konfirmim nga ZVRPP
2	Ardian Petrit Burimi dhe bashkëpronarët	227/5	8527	Arë	5000	222	1110000	Konfirmim nga ZVRPP
3	Çlirimtar Abedin Kotherja Fatmir Abedin Kotherja	227/3	8527	Arë	6000	222	1332000	Konfirmim nga ZVRPP
Totali					14500		3219000	